




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0034527-2/0 dt. 22.06.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 8, 16, 17 dhe 18 të Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Propozim-Vendimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 01-020/04-0034527/26, dt. 15.06.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin e Projekteve në Fushën e Sportit për Projekte/Programe të OJQ-ve për Thirrjen Publike për Vitin 2026)

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e projekteve të cilët kanë aplikuar në Thirrjen Publike për financim të OJQ-ve në fushën e sportit për projekte/programe për Thirrjen Publike për Vitin 2026, në këtë përbërje:
 - 1.1 Nazmi Racaj – kryesues (DKRS);
 - 1.2 Bedri Murati – anëtar (DEZHTIE);
 - 1.3 Fjolla Carani – anëtare (DBF);
 - 1.4 Edin Lahi - anëtar (Ekspert);
 - 1.5 Elmir Aliu - anëtar (Përfaqësuese nga Shoqëria Civile);
 - 1.6 Arjeta Musa Hoti - anëtare rezervë (DKRS).
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë vlerësimin e të gjitha projekteve që janë dorëzuar për përfitimin e subvencioneve në fushën e sportit në përputhje me Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve duke bërë vlerësimin e tyre si nga aspekti procedural, po ashtu dhe ai përmbajtjesor në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh.
3. Gjatë fazës së vlerësimit komisioni obligohet që të mbajë Procesverbal nga momenti i hapjes së procesit e deri në marrjen e Vendimit për secilin projekt, duke përfshirë dhe pikët me rastin e vlerësimit. Pas përfundimit të vlerësimit komisioni duhet të përgatitë një raport të përgjithshëm me projektet e miratuara, po ashtu dhe ato të refuzuara së bashku me listën e përfituesve dhe të njëjtin të publikoj në ueb faqen e komunës brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e marrjes së Vendimeve.
4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Ligjin Nr. 05/L-031 për



Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e fazës së vlerësimit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

PECI

Shtojcë:

1x1 Propozim - Vendimi i DKRS-së, Nr. 01-020/04-0034527/26, dt. 15.06.2026.

Ti dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

